

*Ligjshke*

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**MINISTRIA E EKONOMISE PUBLIKE DHE PRIVATIZIMIT**  
**DREJTORIA E PRIVATIZIMIT**

**U R D H E R**

Nr. 142/1 Date 5.08.1998

PER  
ZVOGELIMIN E KAPITALIT TE SH.A "DUHAN CIGARE "

SHKODER

Me cilesine e aksionerit te vetem te Sh.A. "Duhan Cigare " Shkoder , bazuar ne paragrafin e pare te nenit 2 te Ligjit 8237, date 1.9.1997 "Per disa ndryshime ne ligjin 7926, date 20.4.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare", ndryshuar me dekretin Nr.1195, date 14.8.1995, Ligjin Nr.8099, date 28.3.1996; Dekretin Nr.1631, date 1.11.1996 dhe Ligjin Nr.8158, date 7.11.1996, dhe ne baze te nenit 128 te Ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare"

Urdheroj :

1. Ne aktet e themelimit te Sh.A "Duhan Cigare " Shkoder, te behen ndryshimet e meposhtme :

Ne kapitalin themeltar te shoqerise anonime "Duhan Cigare" Shkoder, te zbritet vlere e godines se zyrove te administrates e cila me Urdher te perbashket te A.R.N. -se Nr 1173/1 date 06.12 1995 dhe Drejtorise se Pergjithshme te Arkivave , Tirane Nr 8/67 date 01.12 1995 u be kalim kapital kesaj Drejtorie me vlere 1.951.328 leke, si dhe vlere e mjeteve te transportit ,makineri pajisje dhe inventar ekonomik 522.672 leke te privatizuara .Gjithsej shuma qe zbritet eshte 2.474.000 leke dhe numri i aksioneve 2.474. Kapitali themeltar gjithsej mbetet 279840000 dhe numri i aksioneve 279 840.

2. Ngarkohet Drejtoria e Privatizimit te beje veprimet perkatese per zvogelimin e kapitalit ne perputhje me parashikimet e nenit 33 te Ligjit Nr.7667 "Per rregjistrin tregtar dhe formalitet qe duhen kryer ne te".



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT TIRANE  
Nr. 14.6/2 Akt.

V E N D I M  
I  
GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 01.08.2000 une, gjyqtare e Gjykates se Rrethit Tirane Olinda Spica, sot me date 01.08.2000 mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga ~~Zv. Ministri I~~ Ekonomise Publike dhe Privatizimit per depozitimin ne regjistrin tregtar te urdherit nr 142/2 date 31.07.2000 te Ministrit te Ekonomise Publike dhe Privatizimit Z. Mustafa MUCI dhe

Konstatova :

Se Sh.a Duhan Cigare sh.a Shkoder eshte regjistruar si person juridik ne Gjykatën e Rrethit Tirane me vendimin nr 14616 date 23.4.1996 me kapital themeltar 282.314.000 leke. Me urdherin nr 142/1 date 5.8.1998 te Ministri te Ekonomise Publike dhe Privatizimit eshte vendosur zvogelimi I kapitalit per vleren 2.474.000 leke ne shoqeri anonime Duhan Cigare sh.a Shkoder dhe kapitali themeltar behet 279.840.000 leke dhe numri I aksioneve 279.840. Me urdherin nr.142/2 date 31.7.2000 behet zvogelimi I kapitalit themeltar te shoqerise me vleren 42.620.000 leke. Kapitali themeltar behet 237.220.000 leke dhe numri I aksioneve 237.220. Nga shqyrtimi I akteve te paraqitura nga kerkuesi rezulton se ato jane te plota dhe kerkesa e bazuar ne ligj.

Per kete arsye:

Ne baze te nenit 24 te Ligjit Nr 7667, date 28.01.1993

VENDOSA:

- Pranimin e kerkeses.

-Depozitimin e urdherit 142/2 date 31.7.2000 te aksionerit te shoqerise duke bere shenimin ne fletën perkatese te regjistrit ne kollonen 4 dhe 5 me nr rendor 2

Te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri .Te publikohet vendimi I mesiperm.

GJYQTARE  
Olinda Spica

**PROJEKT I EKSPERTES KONTABEL TE AUTORIZUAR**  
**për zvogëlimin e kapitalit të SH.A.Duhan-Cigare Shkodër**

Në bazë të misionit që më është ngarkuar si eksperte kontabël gjithë vjetore e shoqërisë SH.A.Duhan-Cigare paraqes projektin e meposhtem për zvogëlimin e kapitalit të kësaj shoqërije.

Mbasi verifikova dokumentacionin pëekates që ndodhet pranë shoqërise,duke u bazuar në bilancin e mbylljes së vitit 1994 dhe bilancin reformues të kalimit të Ndermarrjes Duhan-Cigare ne shoqeri tregtare arrita ne perfundimin se:

Në momentin që kjo shoqëri nga nderrmarje shtetërore kthehet në shoqëri tregtare ka një kapital fillestar në shumen 282,314,000, lekë duke pëefshirë dhë vlerën e tokës.Në bilancin e fundit te vitit 1996 vlera e kapitalit te shoqërisë është zvogeluar nga ndikimi i ndryshimeve të mëposhtme:

1.Me urdhër të përbashkët të A.R.N.-së Tiranë me numër 1173/1 datë 06.12.1995 dhe Drejtorisë të Pergjithshme të Arkivave Tiranë numër 8/67 datë 01.12.1995,ndertesat e zyrave të administrates te kësaj shoqërije kalojnë transferim kapital Drejtorisë së Pergjithshme te Arkivave në shumën 2,336,137. lekë nga e cila vlera fillestare e ndertesave është1,328,137 lekë ndersa vlera e mbetur 943,328 lekë ndërsa vlera e tokës1,008,000. lekë (2100 m<sup>2</sup>X480)

2.Mbas hartimit të bilancit reformues me kërkesen e kësaj shoqërije dhe miratimin e A.K.P.-së Shkodër jane bërë shitje (privatizim)

a Automjete copë 2 (dy) me vlerë fillestare 841,720 lekë te cilat i kane patur në pëedorim punonjesit dhe vlera e mbetur r tyre është294,604 lekë.

bMakineri e paisje te repartit te zdrukthtarisë e ofiçinës që i kane patur ne ngarkim punonjesit me vlere fillestare 484,800 leke dhe vlere të mbetur 209,100 lekë

c Inventar ekonomik në ish zyrat e administrates si tavolina pune,ventilator,decimar,etj.që jane shitur punonjsve .Vlera fillestare në kontabilitet ka qënë 50,041 lekë dhe vlera e mbetur është 18,968 lekë..

Si rezultat i ndryshimeve që theksuam më siper kapitali i shoqërisë pakësohet në shumen 2.474,000 lekë d.m.th. nga 282,314,000 lekë që ka qënë në momentin e krijimit të Shoqërisë, mbetet në fakt 279,840,000 lekë.

Për ndryshimet që theksuam veprimet kontabel janë kryer si më poshtë:


1.Ndertesat e administates	1.328.137	384.809	943.328
2.Toka e zyrave	1.008.000	---	1.008.000
3.Mjete transporti cope 2	841.720	547.116	294,604
4.Makineri e pajisje	484.800	275.700	209.100
5.Inventar ekonomik	50.041	31.073	18.968
<b>Totali i paksimeve</b>	<b>3,712,698</b>	<b>1,238,698</b>	<b>2,474,000</b>

Duhet theksuar se ndryshimet në ulje të kapitalit janë pasqyruar në bilancin e vitit 1997.

Shkodër,korrik '98

Eksperte Kontabël e Autorizuar

Irena PULAJ

  
Irena PULAJ  
ALBANIA

# R A P O R T

## I

### EKSPERTIT KONTABEL TE AUTORIZUAR

#### PER ZVOGELIMIN E KAPITALIT TE SHOQERISE DUHAN CIGARE sh.a. SHKODER

Mbi bazen e Urdherit te Ministrit te Ekonomise Publike e Privatizimit nr. 142/2, d.t.5.04.2000 dhe nr. 277, d.t. 31.05.2000 " Per zvogelimin e kapitalit themeltar te Shoqerise Duhan Cigare sh.a. Shkoder ", une Irena PULO , Eksperte Kontabel e Autorizuar ndoqa proceduren perkatese per te.

Ne punen time u bazova ne dokumentet e meposhteme :

- dokumentacionin ligjor te shoqerise,
- bilancin e viti 1999, i cili eshte i audituar,
- raportin e vleresimit te pergatitur nga ekspertet vleresues.

Nga verifikimet e kryera konstatova se objektet te cilat do te ndahen nga shoqeria jane te vleresuara nga ekspertet vleresues si me poshte :

Objektet ndertimore :


- Kati perdhe i nderteses se fabrikes se cigareve	8.088.575 leke
- Ndertesa e sherbimit te fabrikes se cigareve	1.659.627 leke
- Ndertesa e kaldajes	<u>1.130.972 leke</u>
<b>GJITHSEJ</b>	<b>10.879.174 LEKE</b>

Gjithashtu nga ekspertet vleresues eshte ndare edhe vlefte e truallit qe do te pakesohet nga aktivet e shoqerise, e cila eshte e barabarte me **1.989.216 LEKE.**

Nga shoqeria u pergatit inventari i makinerive e pajisjeve qe jane kerkuar nga punonjesit per tu privatizuar te ndara keto sipas reparteve. Vlefte neto e tyre qe do te pakesoj edhe kapitalin e shoqerise llogaritet **22.319.635 LEKE.**

Gjithashtu , ne zbatim te Urdherit te Ministrit nr. 277, d.t. 31.05.2000, nga shoqeria u pergatit lista e makinerive e pajisjeve qe nuk jane ne gjendje pune qe do te kalojne ne procedure privatizimi. Shuma e ketyre makinerive eshte **7.435.208 LEKE.**

Nga ana e shoqerise duhet te behen veprimet ne kontabilitet duke pakesuar aktivet sipas vleres bruto te tyre dhe amortizimin perkates.

  
I. E. K. A  
IRENA PULO  
ALBANIA

Gjithashtu, pakesimet ne aktivet e shoqerise do te paraqiten ne dy linja te vecanta si aktive te paperfshira ne kapital :

- ndertesat, trualli dhe makinerite ne to	35.188.025 leke
- makinerite e tjera jo ne gjendje pune	7.435.208 leke

Pas veprimeve te mesiperme, kapitali i shoqerise pakesohet per 42.623.233 leke. Gjykoj qe per efekt rrumbullakimi, te pakesohet per 42.620.000 leke.

**Si perfundim, kapitali i shoqerise pas ndryshimeve te mesiperme nga 279.840.000 leke behet 237.220.000 leke, kurse diferenca nga rivleresimi nga 32.558.774 leke behet 31.231.649 leke.**

Bashkangjitur ketij raporti, eshte edhe bilanci i pergatitur nga shoqeria pas ndryshimeve te mesiperme.

#### EKSPERTE KONTABEL E AUTORIZUAR

Shkoder, KORRIK 2000

Irena PULO  
I.E.K.A.  
IRENA PULAJ  
ALBANIA

Shenim: Shifrat e mesiperme perputhen me vleresimet e beja nga ekspertet vleresues. Ne kontabilitet, vlera neto e aktiveve qe pakesohet eshte 43.947.125 leke. Diferenca eshte risternuar me rezervën e rivleresimit.

Eksperte Kontabil e Autorizuar  
Irena Pulo  
I.E.K.A.  
IRENA PULAJ  
ALBANIA



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E ZHVILLIMIT  
EKONOMIK, TREGTISË  
DHE SIPËRMARRJES  
DREJTORIA E PËRGJITHSHMË E PRONËS SHTETËRORE  
DREJTORIA E PRIVATIZIMIT

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3      Tel: ++355 ...; Fax: ++355 4 251 388

Nr.      Prot.      Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2014

URDHËR

Nr. 376 Datë 22/07/2014

PER

ZVOGËLIMIN E KAPITALIT TË SH.A "DUHAN CIGARE" SHKODËR

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe në bazë të paragrafit të parë të nenit 2 të Ligjit Nr. 8237, datë 01.09.1997 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 7926, datë 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", ndryshuar me Dekretin Nr. 1195, datë 14.08.1995, Ligjin Nr. 8099, datë 28.03.1996, Dekretin Nr. 1631, datë 01.11.1996, Ligjin Nr. 8885, datë 22.04.2002, Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe urdhrin Nr. 233, datë 11.4.2014 të MZHETS, me cilësinë e aksionarit të vetëm të Sh.a " Duhan Cigare " Shkodër,

URDHËROJ:

1. Kapitali Themeltar të zvogëlohet për vlerën 10 680 169 lekë , i barabartë me 10 680.1 aksione me vlerë nominale 1000 lekë secila, që i përket objektit "ish uzina e fermentimit" ne pronësi te shoqërisë " Duhan Cigare" Shkodër.
2. Kapitali Themeltar i shoqërisë bëhet 226 539 831 lekë, i barabartë me 226 539.8 aksione me vlerë nominale 1000 lekë secila.
3. Këto ndryshime të bëhen në aktet e themelimit të shoqërisë.
4. Bazuar në Ligjin 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" ngarkohet Drejtoria e shoqërisë " Duhan Cigare" Shkodër për kryerjen e veprimeve lidhur me ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

*Aplikanti  
jetmir Lumaq  
[Signature]*

MINISTRI

ARBEN AHMETAJ